

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6686
E martë, 23 gusht 2022
çmimi 0.40

Shqipëria po heton tre të dyshuarit për sulmin në Gramsh



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

ESCOBARI DHE LAJÇAKU VIZITOJNË KËTË JAVË PRISHTINËN DHE BEOGRADIN

FAQE 4-5



© Leon Neal/Getty Images

I dërguari amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar dhe i dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajçak, pritet t'i vizitojnë këtë javë Prishtinën dhe

Beogradin. Ata do të bëjnë përpjekje për t'i bindur palët që të arrijnë marrëveshje për tejkalimin e tensioneve në veri të Kosovës si dhe për çështjen e targave të veturave dhe dokumentet serbe

AKTUALE



BOMBARDUESIT AMERIKANË FLUTUROJNË MBI BALLKANIN PERËNDIMOR F. 2

HARADINAJ PARALAJMËRON TAKIME ME QYTETARË PËR DIALOGUN DHE GJENDJEN EKONOMIKE F. 5

203 RASTE TË REJA ME COVID F. 6

ZIADIN SELA JEP DORËHEQJE NGA POZITA E KRYETARIT TË ALEANCËS PËR SHQIPTARËT F. 7

EKONOMI



RRETH 20 MIJË ADHURUES TË BIRRËS MORËN PJSË NË 'BEERFEST KOSOVA 22' F. 8

DOGANA E KOSOVËS KAP MBI 18 MIJË EURO TË PADEKLARUARA F. 8

SPORT



FILLON SHITJA E BILETAVE PËR NDESHJEN BALLKANI - SHKUPI, ÇMIMET PËRTOKË F. 8

NAGAVCI, SBASHK-ut: KËRCËNIMET PËR GREVË NUK MUND TË VAZHDOJNË, MËSIMI NIS SIPAS PËRGATITJEVE

FAQE 7



Ministrja e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit, Arbërie Nagavci, ka thënë se parajmërimet e SBASHK-ut për ndërprerje të procesit mësimor kundrejt rrit-

jes në paga nuk kanë arsyetim. Ajo ka bërë me dije të hënën se MASHTI, në koordinim me komunat, i ka bërë përgatitjet e duhura për fillimin e vitit të ri shkollor



AKTIVIZOHET SHËRBIMI I HEMODIALIZËS NË KLINIKËN E PEDIATRISË

FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçishtë - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Bombarduesit amerikanë fluturojnë mbi Ballkanin Perëndimor

PRISHTINË, 22 GUSHT - Dy avionë bombardues amerikanë të llojit "B-52" kanë fluturuar mbi shtetet e Ballkanit Perëndimor të hënën, më 22 gusht.

Këto fluturime janë kryer për të treguar përkushtimin ndaj aleatëve të NATO-s, teksa janë rritur tensionet për shkak të pushtimit rus të Ukrainës. Dy fluturimet do të realizojnë fluturime të ulëta mbi ndërtesën e Qeverisë së Maqedonisë së Veriut në Shkup dhe mbi sheshin "Skënderbej" në Tiranë të Shqipërisë.

Bombarduesit më pas do të fluturojnë mbi bregdetin e Malit e Zi dhe mbi Dubrovnik të Kroacisë.

"Qëllimi i këtyre fluturimeve është për të demonstruar përkushtimin e Shteteve të

Bashkuara dhe për të siguruar aleatët e NATO-s dhe partnerët tanë që gjenden në Evropën Juglindore", është thënë në deklaratën e forcave ajrore amerikane në Evropë.

Avionët luftarakë "B-52H Stratofortress" janë avionë me rreze të gjatë veprimi dhe kanë aftësi që të bartin bomba dhe të kryejnë sulme me një seri armësh të inventarit të ushtrisë amerikane.

Aleatët e NATO-s po dërgojnë anije dhe avionë luftarakë për të forcuar krahun lindor të Aleancës në kundërpërgjigje ndaj agresionit të Rusisë në Ukrainë.

Në qershor, forcat ajrore amerikane kishin dërguar dy avionë F-35 për të kryer fluturime mbi shtetet e Baltikut.



Gjenerali ukrainas: Afër 9 mijë ushtarë të vrarë në luftën kundër Rusisë



KIEV, 22 GUSHT - Pothuajse 9 mijë pjesëtarë të ushtrisë ukrainase janë vrarë gjatë luftës kundër Rusisë, tha më 22 gusht shefi i forcave të armatosura të Ukrainës.

Shifra e prezantuar nga gjenerali Valeriy Zaluzhnyi, duket se është shifra e parë e ofruar nga një zyrtar i lart ushtarak ukrainas për humbjet në luftë, qëkur Rusia nisi pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt.

Zaluzhnyi, komandant i forcave të armatosura ukrainase gjatë një konference për media në nderim të veteranëve dhe familjeve të ushtarëve të vrarë,

ka thënë se fëmijët duhet të mbrohen në disa pjesë të shtetit, përfshirë në kryeqytet, Kiev. "Ata nuk e kuptojnë se çfarë po ndodh dhe duhet t'i mbrojmë... sepse baballarët e tyre kanë shkuar në fronte të luftës dhe ndoshta janë në mesin e pothuajse 9.000 heronjve që janë vrarë", ka thënë ai.

Zaluzhnyi nuk ka dhënë detaje të tjera për shifrën e ofruar të ushtarëve të vrarë, por ka thënë se aty përfshihen pjesëtarët e personelit ushtarak të vrarë në luftime, sikurse edhe rojet kufitare.

Ndërsa presidenti ukrainas, Volodymyr Zelensky, ka thënë se

rreth 1 milion persona janë duke e mbrojtur Ukrainën si pjesë e forcave të armatosura dhe shërbimeve të tjera ukrainase.

Më tutje, gjenerali Zaluzhnyi nuk ka treguar se sa civilë janë vrarë apo sa ushtarë rusë, sipas Kievit, janë vrarë në luftime. Por, Shtabi i Përgjithshëm i forcave të armatosura ukrainase ka thënë se deri më tani janë vrarë 45 mijë e 400 rusë. Në anën tjetër, Rusia nuk ka treguar sesa ushtarë të saj janë vrarë në fushëbetet në Ukrainë. Shifrat e ofruara nga Ukraina për humbjet e Rusisë nuk kanë mundur të verifikohen në mënyrë të pavarur.

BE-ja shqyrton mundësinë e trajnimit të forcave ukrainase



BRUKSEL, 22 GUSHT - Bashkimi Evropian (BE) do të diskutojë për nisjen e një programi të madh trajnues për forcat ukrainase në shtetet fqinje, ka thënë shefi i diplomacisë së bllokut, Josep Borrell.

Duke folur në një konferencë për media më 22 gusht në Santander të Spanjës, Borrelli, ka thënë se për këtë temë do të diskutohet javën e ardhshme gjatë takimit në Pragë të ministrave të Mbrojtjes së BE-së. "Natyrshisht se do të ishte një

mision i madh", ka thënë ai, duke shtuar se "çdo mision duhet të jetë i përgatitur" për të trajnuar forcat ukrainase për luftë.

Informacionet e inteligjencës dhe pajisjet ushtarake të ofruara nga Shtetet e Bashkuara dhe Evropa Perëndimore kanë ndihmuar forcat ukrainase që të ngadalësojnë - por jo të ndalin - përparimin e forcave ruse në lindje të Ukrainës dhe përgjatë brigjeve të Detit të Zi. "Duket e

arsyeshme, duke pasur parasysh se lufta po zgjat, që duhet një përpjekje tjetër përveç ndihmës me materiale. Për këtë po diskutohet midis shteteve anëtare dhe do të bisedohet për këtë temë edhe në nivelin politik javën e ardhshme", ka thënë Borrelli. Qëkur Rusia nisi pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt, ShBA-ja dhe shtetet e tjera, përfshirë edhe ato evropiane, i kanë ofruar ndihmë ushtarake forcave ukrainase.

Presidenti i Austrisë aksidentohet në mal

VJEN, 22 GUSHT - Presidenti i Austrisë, Van der Bellen, ka pësuar lëndime të lehta teksa

ecte në mal, të dielën pas dite. Ai ka rrëshqitur në një shëtitje malore në Kaunegrat dhe është

dërguar në spitalin më të afërt nga shokët e Kobrës. Austria është një vend që njihet për

numër të madh malesh dhe turistë që shkojnë pikërisht për ato bukuri natyrore.





Ish-ambasadori amerikan Delawie: Serbia është kërcënim për paqen në Ballkan, jo Kosova

PRISHTINË, 22 GUSHT - Ish-ambasadori amerikan në Kosovë, Greg Delawie, ka komentuar deklaratat e fundit të president serb, Aleksandër Vuçiç, të bëra në një konferencë për medie, të dielën pas takimit

që pati me përfaqësuesit e Listës Serbe dhe kryetarët e komunave me shumicë serbe në Kosovë. Delawie në "Twitter" ka shkruar se Serbia është kërcënim për paqen në Ballkan, e jo Kosova. "Luftë nxitjeje në Ballkan nga

Vuçiç. Mos gaboni, Serbia është kërcënim real për paqen këtu, jo Kosova. KFOR, forca paqeruajtëse e NATO-s, do ta bëjë punën e vet. Kjo është një histori e shkruar mirë", ka shkruar ai.

Nagavci, SBASHK-ut: Kërcënimet për grevë nuk mund të vazhdojnë, mësimi nis sipas përgatitjeve

Ministrja e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit, Arbërie Nagavci, ka thënë se paralajmërimet e SBASHK-ut për ndërprerje të procesit mësimor kundrejt rritjes në paga nuk kanë arsytim. Ajo ka bërë me dije të hënën se MASHTI, në koordinim me komunat, i ka bërë përgatitjet e duhura për fillimin e vitit të ri shkollor

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 22 gusht - Ministrja e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit, Arbërie Nagavci, ka bërë me dije se kjo ministri, në koordinim me komunat, i ka bërë përgatitjet e duhura për fillimin e vitit të ri shkollor. "Angazhimi ynë është shumëdimensional, për përmirësimin e infrastrukturës

në shkolla, avancimin e infrastrukturës ligjore, që të kemi staf të kualifikuar, tekste cilësore, kabinete e laboratorë, në mënyrë që t'i përmirësojmë rezultatet në arsim. Ne jemi të përkushtuar dhe me plot vullnet për fillimin e vitit të ri mësimor. Të njëjtin vullnet e shpreh në të gjitha shkollat në vend. Falënderuese e mirënjohëse ndaj të gjithë mësimdhënësve që punojnë pa u lodhur për zhvillimin e

gjeneratave të reja, për përkushtimin në klasë, përkushtimin për nxënës, pasionin për mësimdhënie. Pagë dhe kushte të dinjitetshme për mësimdhënësit tanë", ka thënë Nagavci.

Ajo ka theksuar se ky premtim do të jetësohet me Ligjin e ri për Paga. "Mësimdhënësit tanë të të gjitha niveleve pa përjashtim janë trajtuar me kujdes të veçantë. Jo neglizhim i mësimdhënësve dhe edukatorëve të nivelit parashkollor, por paga dhe kushte të punës së favorshme. Përkundër të gjithë punës sonë, mësimdhënësit janë epiqendra e reformës në arsim, andaj edhe ky rrugëtim ynë është i përbashkët me ta. Ristrukturimi i

procesit të vlerësimit të performancës, licencimit dhe zhvillimit profesional të mësimdhënësve do t'i japin kuptim edhe rritjes në paga", ka deklaruar Nagavci.

Ajo ka thënë se paralajmërimet e SBASHK-ut për ndërprerje të procesit mësimor kundrejt rritjes në paga nuk kanë arsytim. "Ky cikël i përsëritshëm i kërcënimeve nuk mund të vazhdojë më. SBASHK-u gëzon të drejtë të garantuar ligjore për organizim dhe reagim sindikal, por nuk mund ta cenojë të drejtën kushtetuese të nxënësve për shkollim. Nuk ndërpritet procesi mësimor sa herë që dikush dëshiron! Jam shumë e bindur për përkushtimin e mësimdhënësve dhe

përgjegjësinë që të njëjtët ndiejnë ndaj nxënësve", është shprehur ministrja e Arsimit.

Nagavci ka theksuar se sindikatat janë partneret e tyre sociale. "Andaj dhe kemi shqyrtuar çdo kërkesë të tyre. Projektligji i ri i Pagave adreson rangimin e punëtorëve të arsimit edhe më mirë sesa SBASHK-u kishte kërkuar e që ishte pajtuar, me ish-qeverinë, andaj edhe procesi mësimor s'bën të pengohet. Kemi një rrugë të gjatë së bashku edhe këtë vit mësimor dhe sfidat nuk do të mungojnë. Çdo orë dhe ditë mësimore është përgjegjësi ndaj nxënësve për një shkollim më të mirë", ka thënë ministrja e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit, Arbërie Nagavci.



Nga tri orë pritje në Merdar për të dalë nga Kosova

PRISHTINË, 22 GUSHT - Bashkatdhetarët tanë të cilët kanë filluar të kthehen nëpër vendet ku jetojnë e punojnë, po vazhdojnë të përballen me

pritje të gjata në kufi për të dalë nga Kosova. Qendra Kombëtare për Menaxhim Kufitar, në kuadër të Ministrisë së Punëve të

Brendshme, ka njoftuar se të hënën në Merdar udhëtarët po presin mbi tri orë për të dalë nga Kosovë, ndërsa kolona është e gjatë një kilometër e gjysmë.

Pritje ka edhe në pikën kufitare Dheu i Bardhë. Njoftohet se për të dalë nga Kosova mërgimtarëve u duhet të presin 60 deri në 70 minuta.





© Leon Neal/Getty Images

Escobari dhe Lajçaku vizitojnë këtë javë Prishtinën dhe Beogradin

I dërguari amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar dhe i dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajçak, pritet t'i vizitojnë këtë javë Prishtinën dhe Beogradin. Ata do të bëjnë përpjekje për t'i bindur palët që të arrijnë marrëveshje për tejkalimin e tensioneve në veri të Kosovës si dhe për çështjen e targave të veturave dhe dokumentet serbe

PRISHTINË, 22 GUSHT - I dërguari amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar dhe i dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajçak, pritet t'i vizitojnë këtë javë Prishtinën dhe Beogradin, mëson "Radio Evropa e Lirë" nga burimet diplomatike në Bruksel. "Radio Evropa e Lirë" ka marrë vesh nga burimet e saj se Escobari dhe Lajçaku do të qëndrojnë të mërkurën në Prishtinë. Sipas këtyre burimeve, ata do të bëjnë përpjekje për t'i bindur palët që të arrijnë marrëveshje për tejkalimin e tensioneve në veri të Kosovës si dhe për çështjen e targave të veturave dhe dokumentet serbe. Në takimin e fundit të nivelit të lartë në Bruksel, që është mbajtur më 18 gusht, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, nuk kanë arritur marrëveshje për këto

çështje. Megjithatë, burimet e BE-së kanë thënë se "do ta vazhdojnë punën intensive në kërkim të zgjidhjes" dhe se "derisa të mos arrihet zgjidhja, nuk do ta konsiderojnë këtë raund të dialogut si të përfunduar". Në Bruksel diplomatët pranojnë se ka hapësirë për rritjen e tensioneve, prandaj edhe duan që të dyja palët të jenë të përgjegjshme, të kërkojnë zgjidhje dhe t'i evitojnë sjelljet që mund të shkaktojnë përshkallëzim të situatës. Në BE e kanë përsëritur se "nuk duan të shohin në Kosovë skena çfarë janë parë në fund të muajit korrik dhe fillim të muajit gusht". Fakti se Escobari dhe Lajçaku pritet të shkojnë së bashku në Beograd dhe Prishtinë, shihet si dëshmi se BE-ja dhe ShBA-ja po punojnë së bashku në drejtim të arritjes së një zgjidhjeje për çështjet e targave dhe dokumenteve serbe. Shtetet e Bashkuara e kanë përsëritur se mbështesin

plotësisht procesin e ndërmjetësuar nga blloku evropian.

Ndërkohë zyrtarë të BE-së i janë falënderuar ShBA-së për rolin aktiv dhe konstruktiv në kërkim të zgjidhjes dhe në mbështetje të dialogut.

Esobari ka qëndruar në Bruksel më 18 gusht, kur është zhvilluar dialogu në mes të Kurtit dhe Vuçiqit.

Ai është takuar ndaras me të dy liderët dhe Lajçakun.

Burimet diplomatike në Bruksel pohojnë se këto ditë ka interesim dhe angazhim të shtuar edhe të disa liderëve perëndimorë për të gjetur zgjidhje.

Vetë përfaqësuesi i lartë i BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Josep Borrell, ka thënë, pas takimit të liderëve të Kosovës dhe Serbisë, se ka kohë deri më 1 shtator, ndonëse ka tërhequr vërejtjen se koha "po ecën".

Nga takimet e të dërguarve të posaçëm të BE-së dhe ShBA-së në Prishtinë dhe Beograd do të varet nëse do të ketë takim të ri në kuadër të dialogut në Bruksel dhe, nëse po, në çfarë niveli.

Pse pati tensione në veri?

Takimet në Bruksel u thirrën pasi serbët lokalë më 31 korrik dhe 1 gusht vendosën barrikada si shenjë pakënaqësie ndaj

vendimit të Qeverisë së Kosovës për zbatim të dy vendimeve: për targat e makinave dhe dokumentet serbe.

Kosova dhe Serbia kanë marrëveshje për lëvizje të lirë prej vitit 2011.

Serbia e ka zbatuar atë menjëherë.

Kosova e ka zbatuar më 1 gusht - për pak orë - pikën për dokumentin për hyrje/dalje dhe e ka shtyrë zbatimin e vendimit për 1 shtator, me qëllim të uljes së tensioneve në veri.

Ndërkohë serbët i kanë hequr barrikadat.

Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian kanë kërkuar, po ashtu, një shtyrje të tillë, ndonëse kanë thënë se Kosova ka të drejtë t'i zbatojë këto vendime.

Qeveria e Kosovës ka thënë se kryeministri Kurti ka diskutuar për dy tema në takimet e 18 gushtit. Sipas qeverisë, në takim është diskutuar për kornizën e përgjithshme të marrëveshjes përfundimtare. Sipas saj, Kurti ka theksuar se kjo marrëveshje duhet të ketë në qendër njohjen reciproke, prandaj edhe "ka prezantuar disa kapituj me elemente përkatëse që duhet t'i përmbajë kjo kornizë". "Tema e dytë ishin çështjet aktuale politike e të sigurisë për të cilat kryeministri Kurti tregoi për rëndësinë e ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë në vendin tonë si garancione të paqes, sigurisë dhe barazisë për të

gjithë qytetarët pa dallim", është thënë në komunikatën e qeverisë më 18 gusht.

Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka thënë më 21 gusht në Beograd se ka marrë mbështetjen e përfaqësuesve të serbëve nga Kosova për një

zgjidhje kompromisi për çështjen e targave dhe dokumenteve serbe.

Sipas tij, Serbia nuk do të lejojë kolona të refugjatëve dhe se në raundin e fundit të dialogut, Kosova ka folur për një marrëveshje përfundimtare prej gjashtë

pikash.

Pas takimit me përfaqësuesit serbë nga Kosova, Vuçiqi ka thënë para kombit se nuk e di se cila mund të jetë zgjidhja e kompromisit për çështjen e targave dhe dokumenteve serbe.

"Sapo ta kuptoj, do t'ju njoftoj. Ne do të përpiqemi, do të bëjmë më të mirën. Nëse mundemi, mundemi; nëse nuk mundemi, nuk mundemi".

Dialogu mes Kosovës dhe Serbisë ka nisur 11 vjet më parë. Deri më tani janë arritur më shumë se 20 marrëveshje në fushat si ajo e energjisë, telekomunikacionit, drejtësisë, doganave, lirisë së lëvizjes, por jo të gjitha janë zbatuar.

Kosova insiston që dialogu për normalizim të marrëdhënieve të përmbyllet me njohje reciproke në mes të të dyja vendeve.

Serbia, në anën tjetër, kërkon zgjidhje kompromisi.

Lista Serbe bën edhe një kërcënim për dalje nga institucionet e Kosovës



PRISHTINË, 22 GUSHT - Lista Serbe të hënën edhe një herë ka kërcënuar se do të largohet nga institucionet e Kosovës nëse “nuk arrihet një zgjidhje kompromisi për targat dhe dokumentin e hyrje-daljes të Kosovës”. “Së pari ne politikanët, e pastaj të gjithë me radhë, edhe prokurorët, edhe gjyqtarët, edhe policia”, tha Goran Rakiq, kryetar i Listës Serbe, gjatë një fjalimi për media të caktuara serbe në veri të

Kosovës. “Në këtë mënyrë do të ketë një shpërbërje totale të dialogut të Brukselit”, shtoi ai. Lista Serbe ripërsëriti se i ka dhënë mbështetje të plotë presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, për të gjetur një zgjidhje kompromisi në 10 ditët e ardhshme, por me garanci se nuk do të lejohet “persekutimi dhe pogromi” i popullit serb. Beogradi zyrtar kundërshton vendimin e fundit të Kosovës për

t’u lëshuar dokument për hyrje/dalje atyre që posedojnë dokumente serbe pas hyrjes në Kosovë. Ata posaçërisht janë kundër faktit që një gjë e tillë vlen për serbët në veri të Kosovës, ku janë katër komuna me shumicë serbe. Serbia ka lëshuar një dokument të tillë për qytetarët e Kosovës që kur për këtë ishte rënë dakord në Bruksel mes dy palëve në vitin 2011.

Përveç atij dokumenti, autoritetet e Kosovës kanë vendosur edhe që të gjitha automjetet me targa të lëshuara nga Serbia për qytetet e Kosovës të reregjistrohen në ato të Republikës së Kosovës - RKS. Veturat me targa të tilla si KM, PR e të ngjashme deri më tani kanë lëvizur vetëm në veri. Për shkak të vendimeve të tilla, serbët në veri ngritën barrkada në këtë pjesë para fillimit të zbatimit të tyre më 1 gusht, për t’i

hequr ato pasi Qeveria e Kosovës e shtyu zbatimin për një muaj. Në takimin e javës së kaluar mes presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, dhe kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, në Bruksel, nuk u arrit marrëveshje për këtë çështje. Serbia kërkoi që lëshimi i dokumentit të Kosovës të mos vlejë për qytetarët në veri të Kosovës dhe që automjetet të reregjistrohen me targa status-neutrale, KS, në vend të RKS.

Haradinaj paralajmëron takime me qytetarë për dialogun dhe gjendjen ekonomike

PRISHTINË, 22 GUSHT - Lideri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka paralajmëruar takime me qytetarë për dialogun me Serbinë dhe gjendjen ekonomike në vend. Ai ka bërë me dije se këto takime do t’i nisë në javën e parë të shtatorit. “Të nderuar anëtarë dhe simpatizantë të Aleancës, të nderuar qytetarë të Kosovës, procesi i dialogut, situata e krijuar politike dhe ekonomike në vend, na shtynë të jemi më të angazhuar e më të fokusuar si

asnjëherë më parë. Që nga java e parë e shtatorit të këtij viti do të filloj një proces bashkëbisedimi me qytetarët e Kosovës në vendbanime të ndryshme të vendit. Do të flasim hapur për dialogun për njohje reciproke Kosovë - Serbi, për situatën e rëndë ekonomike - sociale me theks të veçantë për krizën e rëndë energjetike. Po ashtu, edhe për tema të tjera që sot e preokupojnë vendin dhe qytetarin. Këto ditë do t’ju njoftoj për orarin dhe për vendin e takimeve”, ka shkruar Haradinaj në “Facebook”.



Në Drenas mbahet gara në motoçiklizëm "Hard Enduro - Drenasi 2022"

DRENAS, 22 GUSHT - Të dielën është mbajtur gara e parë e organizuar ndonjëherë në Kosovë "Hard Enduro - Drenasi 2022" në motoçiklizëm, organizuar nga klubi i motoçiklizmit "Motocross Drenasi". Pjesëmarrës ishin më

shumë se 20 garues të cilët garuan në tri kategori kryesore: E1, E2 dhe E3.

Kjo garë u organizua nga klubi "Motocross Drenasi" në bashkëpunim me komunën e Drenasit si dhe nën mbikëqyrjen

e Federatës së Motoçiklizmit të Kosovës.

Ishte një interesim i madh i shikuesve duke ditur që ishte gara e parë në nivel vendi në këtë format.

Fitues i kësaj gare nga Klubi

"Motocross Drenasi" doli Alban Mustafa, i cili zuri zënë vendin e parë në kategorinë E3, Armend Baliu zuri vendin e dytë në kategorinë E1 dhe Flamur Berisha zuri vendin e tretë në kategorinë E1.



Punët e izolimit dhe të nyjave sanitare në shkollën "Rexhep Elmazi" drejt përfundimit

GJILAN, 22 GUSHT - Drejtoresha e Drejtorisë Komunale të Arsimit në Gjilan, Selvete Sylejmani dhe drejtori i Shërbimeve Publike, Mentor Mihovci, kanë vizituar punimet e izolimit dhe nyjave sanitare në shkollën "Rexhep Elmazi". Drejtoresha Sylejmani ka bërë me dije se përpos në shkollën "Rexhep Elmazi", është duke u punuar edhe në shkollat "Ramiz Cernica", "Musa Zajmi", "Thimi Mitko", "Mehmet Isai" etj.,

derisa ka konfirmuar se më 1 shtator do të jetë gjithçka gati për fillimin e vitit të ri shkollor në kushte më të mira. "Në shkollën 'Rexhep Elmazi', në kuadër të programit për efikasitet të energjisë elektrike, është duke u bërë izolimi dhe nyjat sanitare. Puna po shkon shumë mirë. Jemi duke e përcjell në vazhdimësi procesin dhe punimet për t'u siguruar që çdo të jenë sipas standardeve. Synojmë që

punët të kryhen para fillimit të vitit të ri shkollor në mënyrë që nxënësit ta fillojnë mësimin me kushte shumë më të mira", ka thënë Sylejmani.

Ndërkaq drejtori i Shërbimeve Publike, Mentor Mihovci, ka thënë se kanë parë nga afër intensitetin e punimeve në këtë shkollë, duke thënë se së bashku me komisionin përkatës i kanë paraqitur disa vërejtje në mënyrë që të përmirësohen disa aspekte.



Mbahet diskutim publik me biznese në Podujevë për rregulloren e orarit të punës



PODUJEVË, 22 GUSHT - Në sallën e Kuvendit Komunal është mbajtur diskutimi publik me përfaqësues të bizneseve për propozimrregulloren e orarit të punës të bizneseve që operojnë në territorin e komunës së Podujevës. I pranishëm ishte edhe drejtori i Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, Vigan Salihu, i cili e ka paraqitur draftin e rregullores punuar nga grupi punues. Drejtori Salihu theksoi se qëllimi i këtij dëgjimi është

gjetja e një zgjidhjeje të kënaqshme lidhur me orarin e punës për të gjitha bizneset që operojnë në territorin e komunës, qofshin në zonën urbane apo në rurale, ku drejtorja në fjalë do t'i trajtojë të gjitha kërkesat e bizneseve dhe të arrijë ta finalizojë rregulloren.

Përfaqësuesit e bizneseve gjatë diskutimit shprehën opinionet e tyre lidhur me rregulloren, ku si konkluzion vlen të theksohet që u arrit një pajtueshmëri mes bizneseve

që zonat turistike si e Orllanit dhe Kërpimehut të punojnë për shkak të fluksit të vizitorëve në fundjavë, ndërsa bizneset e zonës urbane të mbajnë ditë pushimi. Në kuadër të rregullores për orarin e punës së bizneseve që operojnë në territorin e komunës së Podujevës do të mbahet edhe një takim me qytetarë më 29 gusht, ku të gjithë pjesëmarrësit do të kenë mundësi t'i japin propozimet dhe sugjerimet apo vërejtjet e draftrregullores.

Përurohët projekti "Ndërtimi i sheshit në qendër të qytetit të Rahovecit"

RAHOVEC, 22 GUSHT - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka marrë pjesë në përfundimin e projektit "Ndërtimi i sheshit në qendër të qytetit". Ai ka thënë se është i gëzuar që me këtë projekt Rahovecit dhe kësaj pjese, përveç se do t'i shtohet një pamje më e bukur, posaçërisht qendrës së qytetit, do të ofrojë edhe qasje më të lehtë në hapësira publike të

sigurta, të shëndetshme dhe për të gjithë qytetarët. Projekti bashkëfinancohet nga komuna e Rahovecit dhe Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe kap vlerën 155 959.00 euro. Komuna e Rahovecit merr pjesë me: 80 959.00 euro, ndërsa MZHR-ja me 75 000.00 euro. "Projekti parasheh platenë me fontanë të rrafshët, ulëse, ndriçim të ulët, drunj dekorues dhe elemente

të tjera përcjellëse që do t'i japin pamje të bukur dhe funksionale qendrës së qytetit. Po ashtu, do të trajtohen edhe rrjeti elektrik dhe infrastruktura nëntokësore e kësaj pjese. Duke punuar bashkë e me përkushtim, Rahovecit do t'i japim pamje të re, ndërsa qytetarëve më shumë hapësirë dhe mundësi", ka thënë kryetari Latifi.



203 raste të reja me Covid

PRISHTINË, 22 GUSHT - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit, pas 632 testimeve, janë konfirmuar

203 raste pozitive me Covid dhe në këtë periudhë kohore nuk ka pasur të vdekur nga ky virus. Në 24 orët e fundit janë

shëruar 393 persona, ndërkaq raste aktive me Covid janë 3 195.

Në kuadër të Shërbimit

Spitalor Klinik Universitar të Kosovës po trajtohen 28 pacientë të konfirmuar me Covid-19.



Shqipëria po heton tre të dyshuarit për sulmin në Gramsh

TIRANË, 22 GUSHT - Autoritetet shqiptare po i hetojnë dy shtetasit rusë dhe një ukrainas të arrestuar në uzinën ushtarake të Gramshit për spiunazh. Tre të dyshuarit janë duke u mbajtur në arrest për veprat penale "goditje për shkak të detyrës", "dhënie e informatave sekrete" dhe "sigurim i informatave".

Policia dhe Prokuroria në Elbasan janë duke i hetuar provat materiale të sekuestruara nga të dyshuarit, përfshirë automjetin me të cilin lëviznin, laptopë, dronë dhe aparate celulare.

Dy ushtarë shqiptarë, roje të fabrikës së prodhimit të armëve në qytezën e Gramshit, janë sulmuar të shtunën nga dy shtetas rusë dhe një ukrainas. Sipas Ministrisë së Mbrojtjes, "tre shtetas me pasaporta ruse dhe ukrainase kanë tentuar të hyjnë në uzinë. Menjëherë kanë reaguar efektivet që ishin duke ruajtur uzinën, por gjatë përpjekjeve për t'i ndaluar tre shtetasit e huaj, janë lënduar dy ushtarakët tanë, të cilët janë nën kujdesin e mjekëve në Spitalin e Traumës në Tiranë".


Pas kritikave të shumta ndaj

forcave të sigurisë, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, mbrojti autoritetet shtetërore duke thënë se "institucionet kanë funksionuar siç duhet".

Presidenti i vendit, Bajram Begaj, u bëri thirrje autoriteteve për zbardhjen e ngjarjes dhe parandalimin e situatave që cenojnë sigurinë kombëtare. "Jam në komunikim të vazhdueshëm me strukturat e sigurisë, Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, strukturat e shërbimeve informative dhe ato ligjvënëse, të cilat i inkurajoj dhe i mbështes për ta vazhduar punën për zbardhjen e plotë të ngjarjes", tha presidenti Begaj.

Edhe ambasadorja amerikane në Shqipëri, Yuri Kim, tha se Shtetet e Bashkuara qëndrojnë me Shqipërinë, "tekta autoritetet hetojnë plotësisht për t'i përcaktuar faktet dhe për t'i vënë para përgjegjësisë autorët".

Tre të dyshuarit për spiunazh në dëshmitë e tyre kanë thënë se janë fotografë dhe se kanë blog ku postojnë kryesisht foto dhe video të ish-bazave ushtarake të Bashkimit Sovjetik. Ata kanë



thënë se fotografuojnë kryesisht territore ushtarake që janë të braktisura dhe që nuk përdoren më nga shteti. Gjithashtu, ata kanë treguar se

kanë fotografuar bunkerë dhe tunele të nëndheshme, si dhe vende të uzinës, territore të braktisura.

Uzina e Gramshit është një ndër

tri uzinat ushtarake të Forcave të Armatosura dhe që është përfshirë në procesin e demontimit dhe shkatërrimit të municioneve të tepërta.

Ziadin Sela ka dhënë dorëheqje nga pozita e kryetarit të Aleancës për Shqiptarët



PRISHTINË, 22 GUSHT - Ziadin Sela ka njoftuar për dorëheqje nga drejtimi i partisë opozitare, Aleanca për Shqiptarët në Maqedoninë e Veriut. Shkak për dorëheqjen është disfata e kësaj partie në zgjedhjet e 20 gushtit në Tetovë për asamblenë komunale. Kjo parti nuk ka fituar asnjë vend në përbërjen e re të komunës që numëron 31 këshilltarë. Aleanca për Shqiptarët në Kuvendin e Maqedonisë së Veriut ka tetë deputet, përfshirë edhe Ziadin Selën. "Nga ky moment marr përgjegjësinë dhe jap dorëheqje të parevokueshme si kryetar partie. Në periudhën në vijim organet më të larta të partisë duhet të vendosin se kush do të jetë ushtrues detyre i

kryetarit të partisë", ka deklaruar Ziadin Sela në një konferencë për medie mbajtur në Tetovë.

Zgjedhjet lokale në Tetovë janë fituar nga Lëvizja Besa e cila do të ketë 12 këshilltarë, 11 Bashkimi Demokratik për Integritim, katër VMRO-DPMNE-ja, dy LSDM dhe nga një Partia Demokratike Shqiptare dhe Alternativa.

Kryetar i BDI-së, Ali Ahmeti, gjithashtu ka pranuar disfatën e partisë së tij nga Lëvizja Besa por, sipas Ahmetit, "më me rëndësi se fitorja janë proceset demokratike në Maqedoninë e Veriut".

Pas fitores në zgjedhje, Lëvizja Besa dhe VMRO DPMNE-ja kanë kërkuar zgjedhje të parakohshme parlamentare.

Aktivizohet shërbimi i hemodializës në Klinikën e Pediatriisë

PRISHTINË, 22 GUSHT - Në Repartin e Kujdesit Intensiv të Klinikës së Pediatriisë në Qendrën

Klinike Universitare të Kosovës është aktivizuar Shërbimi i Hemodializës falë ndihmës së një donatori. Ky shërbim deri më tani është kryer në hapësirën e veçantë pranë Repartit të Nefrologjisë në Klinikën e Pediatriisë.

Tani e tutje pacientët do ta

kenë mundësinë të kryejnë shërbimin e hemodializës edhe në Repartin e Kujdesit Intensiv në këtë klinikë.

Aktualisht në repartin e Kujdesit Intensiv është duke u trajtuar një pacient.

Po ashtu, nga i njëjti donator është siguruar komora, e cila shërben për përgatitjen e kimioterapisë, në mënyrë që terapia të bëhet gati më lehtë dhe më shpejt. Pra është bërë

zgerimi edhe i shërbimit për përgatitjen e kimioterapisë në kuadër të hapësirës tek Ambulanca Specialistike e Klinikës së Pediatriisë. Kjo do jetë në shërbim të pacientëve të cilët marrin kimioterapi përmes ambulancave specialistike. Pajisja e komoras ofron një siguri të lartë si për pacientin, po ashtu edhe për personelin shëndetësor.



Dogana e Kosovës kap mbi 18 mijë euro të padeklaruar

PRISHTINË, 22 GUSHT - Oficerët doganorë në pikëkalimin kufitar të Vërmicës kanë parandaluar futjen e 18 250 eurove të padeklaruar. Gjatë kontrolleve rutinore oficerët doganorë kanë selektuar për kontroll një automjet me targa të Republikës së

Kosovës. “Pas ndalimit të automjetit vozitësi dhe pasagjerët kanë deklaruar se nuk posedojnë asgjë, por automjeti është dërguar në vijën e dytë të kontrollit nën asistimin e policisë ku, pas ekzaminimit fizik, te njëri nga pasagjerët në trup (saktësisht në çantën e

krahut) janë gjetur 18 250 euro të padeklaruar. Pala përgjegjëse është gjobitur me 25 për qind të vlerës totale, konform nenit 33.5 të KDAK-së, pjesa tjetër është ndaluar deri në përfundimin e procedurave hetimore”, ka njoftuar Dogana.



Ish-ministri i Energjisë thotë se nuk do të kishte krizë për rrymë nëse do të ndërtohej ‘Kosova e Re’

PRISHTINË, 22 GUSHT - Për krizën energjetike dhe rikthimin e reduktimeve të energjisë elektrike pas disa viteve, po fajësohen qeveritë e kaluara dhe ekzekutivi i tanishëm. Për krizën energjetike me të cilën po përballet Kosova, ish-ministri i Energjisë, Ethem Çeku, po fajëson politikën, duke thënë se sektori i energjisë kërkon një konsensus politik. Kosova, sipas tij, këtë krizë energjetike nuk do ta kishte sikur ta zhvillonte projektin e termocentralit “Kosova e Re”.

Profesori universitar, Çeku, thotë se të vetmet zgjidhje të krizës energjetike në vend janë ndërtimi i blloqeve të vogla deri 200 megavat në bashkëpunim me Bankën Botërore dhe Brukselin si dhe zhvillimi i sektorit të energjisë së ripërtëritshme. “Është problem i madh çështja e energjisë elektrike dhe furnizimit me energji elektrike, u prish projekti ‘Kosova C’ (Kosova e Re), nuk u

zhvilluan ato projekte dhe dihet pse. Dhe tani ne duhet të mendojmë seriozisht, por që nevojitet një konsensus i përbashkët në mes të pozitës dhe opozitës për një plan zhvillimor në fushën e energjisë... A është me faj kjo qeveri për krizën aktuale? Po, normalisht. Të gjithë kemi faj, të gjitha qeveritë bartin përgjegjësi kur është ndërprerë projekti ‘Kosova C’ që ishte paraparë për prodhimin e 1,000MWh energji elektrike dhe që do ta zgjidhte problemin e Kosovës për energji. Dhe u ndërprit ai projekt, dhe të gjitha investimet janë bërë të përkohshme”, thotë Çeku.

Çeku, që shërbeu si ministër në periudhën 2002-2004, thotë se e vetmja zgjidhje e problemit në fushën e energjisë në Kosovë, përpos energjisë alternative, është hapja e mundësive të ndërtimit të blloqeve të vogla deri 200MWh në koordinim me Bankën Botërore dhe Brukselin.



Rreth 20 mijë adhurues të birrës morën pjesë në ‘Beerfest Kosova 22’



PRISHTINË, 22 GUSHT - ‘Beerfest Kosova 22’ përfundoi të dielën, ku për tri natë radhazi, më 19, 20 dhe 21 gusht mbledhi rreth 20 mijë adhurues të birrës.

Nën udhëheqjen e moderatorit Kushtirim Sheremeti, pjesëmarrësit e këtij edicioni patën rastin të argëtohen nga këngëtarë me famë e artistë të rinj, t’i shijojnë birrat e ndryshme dhe të jenë pjesë e lojërave argëtuese.

Speciale në këtë edicion ishte prania e një numri të lartë të birrave pjesëmarrëse nga të cilat pesë vendore dhe

dymbëdhjetë ndërkombëtare. Gjithashtu, festivali kishte karakterin “Green” dhe një pjesë e mbetjeve ka shkuar për riciklim, ka treguar një nga organizatorët e Beerfest Kosova, Ekrem Tahiri. Organizatorët e këtij festivali falënderuan komunën e Prishtinës për bashkëpunimin e mirë dhe Policinë e Kosovës të cilët janë përkujdesur për sigurinë në bashkëpunim me kompaninë e sigurimit GFS, duke mundësuar që festivali të kalojë pa asnjë eksces.

Njëherësh, falënderimin kryesor organizatorët e kanë

drejtuar për 20 mijë pjesëmarrësit e festivalit të cilët kanë treguar se dinë të argëtohen dhe ta bëjnë një festival të tillë shembull për të mirë në rajon. “Populli ynë di të festojë, di të argëtohet dhe di të shijojë një ngjarje të tillë në mënyrën më të mirë”, ka deklaruar Ekrem Tahiri, bashkorganizator i Beerfest Kosova nga kompania MODUS.

Beerfest Kosova, si festival tradicional, do të vazhdojë edhe në vitin 2023 me lokacion të ri dhe me një ndryshim konceptual.

Sekuestrohen 12 krerë gjedhe në Vitomiricë

PEJË, 22 GUSHT - Një kamion me 12 krerë gjedhe është sekuestruar në Vitomiricë të Pejës të dielën në mbrëmje. Policia e Kosovës ka njoftuar se


rasti është iniciuar si tregti e ndaluar. “Njësitë policore gjatë patrullimit kanë ndaluar një kamion të cilin e drejtonte i dyshuari mashkull kosovar.

Gjatë kontrollit i njëjti kishte të ngarkuara rreth 12 copë gjedhe pa dokumente përkatëse. Me vendim të prokurorit rasti shkon në procedurë të rregullt, ndërsa

kafshët dhe kamioni janë sekuestruar dhe janë dërguar në stacionin policor deri në verifikim nga zyrtarët e AVUK-it”, ka njoftuar Policia e Kosovës.



Zersetzung, ja si STASI kontrollonte mendjen e qytetarëve në Gjermaninë Lindore



Nga Emanuel PIETROBON
"Il Giornale"

Fushëbeteja në luftërat e të ardhmes është mendja e njeriut, ose më saktë kontrolli i saj. Sepse kontrolli i një individi, është i barabartë me shndërrimin e tij në një "Kandidat Mançurian", edhe pse jo domosdoshmërisht i programuar për të vrarë, por për të votuar në një mënyrë të caktuar, për të menduar në një mënyrë të caktuar, dhe për të vepruar në mënyrë të parashikueshme. Por edhe sepse të kontrollosh një masë të tërë individësh, pra opinionin publik, do të thotë të kesh në dorë fatet e një shteti. Pra po lind një mënyrë të re të luftës, e quajtur lufta konjitive. Pandemia e Covid-19 dhe lufta në Ukrainë, e kanë përshpejtuar përdorimin e saj. Ndërkohë ishin fillimisht kërkimet e shkencëtarëve nazistë, dhe më pas të dy blloqeve kundërshtarë gjatë Luftës së Ftohtë, ato që hodhën themelet e kësaj lufte. Dhe nëse kërkoni për historikun e kësaj fushe, atëherë me siguri që do të ndeshni një teknike pioniere të përdorur nga STASI, policia sekrete e Gjermanisë Lindore: Zersetzung. Zersetzung, është një term që në gjuhën gjermane mund të ketë një mori kuptimesh, që të

gjitha të ndërlidhura midis tyre, si gërryerje, destabilizim, dekompozim dhe shpërbërje. Kjo është pikërisht ajo që ndodh me mendjen e viktimës së kësaj psikoteknike, e cila hap pas hapi destabilizohet dhe degradohet. Pra Zersetzung kishte të bënte me zbërthimin e mendjes. Është një teknikë e manipulimit konjitiv dhe destabilizimit psikologjik, lindur që në kohën e Gjermanisë naziste, në laboratorët e Kurt Plotner, dhe që pas luftës u perfeksionua nga STASI i frikshëm i Gjermanisë Lindore, duke gjetur një aplikim të gjerë gjatë epokës së Erik Honeker. Synimi ishte dëshira për të luftuar në një mënyrë me më efektive ndaj opozitës politike dhe rezistencës sociale ndaj regjimit komunist. Por edhe sepse shtypja e disidencës përmes forcës fizike mund të rezultonte kundër-produktive. Ndaj duhej diçka e re, e cila ishte e përhapur por e padukshme, e dëmshme por e paprekshme. Zersetzung mendohej se kishte karakteristika të tilla. Me kalimin e viteve 1960, paralelisht me përsosmërinë e metodës Zersetzung, autoritetet gjermano-lindore e reduktuan në mënyrë progresive përdorimin e mjeteve të tilla si përndjekja

gjyqësore dhe dhuna fizike kundër disidentëve, kundërshtarëve dhe kritikëve. Zersetzung, i strukturuar dhe aplikuar nga Gjermania Lindore, u zhvillua nga një grup sociologësh në Juristische Hochschule der Staatssicherheit (JHS), i njohur gjithashtu si Shkolla e STASI-it. Duke u mbështetur në trashëgiminë naziste të propagandës dhe luftës psikologjike, e cila ishte mjaft e gjerë, studiuesit e STASI-t e përsosën Zersetzung-un, duke e bërë atë një metodë për të dëmtuar vetëvlerësimin e viktimës deri në provokimin e krizave serioze të identitetit. Kur goditej me këtë metodë, një kundërshtar politik karizmatik dhe i ndjekur nga policia sekrete, do të niste të përjetonte kohëra veçanërisht të errëta, të shkaktuara nga braktisja shoqërore, aksidentet e çuditshme, izolimi dhe refuzimi. Edhe pse ngjarjet dukeshin si personale, dhe në dukje të shkëputura nga aktivitetet politike të subjektit, ato ishin psikologjikisht destabilizuese dhe të afta të shkaktonte kriza identiteti dhe emocionale. Në fund, lodhja mendore çonte ndonjëherë drejt vetëvrasjes. Çdo mjet ishte legjitim në funksion të degradimit mendor të subjektit të vënë në shënjestër. Kështu, ai mund të

joshej të kryente marrëdhënie seksuale me të mitur, të bëhej pjesë e rretheve sociale problematike, me njerëz të ndërvarur nga droga, apo për ta përfshirë në krime të vogla si vjedhjet. Apo për t'i dhënë rryshfet kolegëve të tij që ta shpërfillin, dhe që shefat e tij në punë ta pengonin në veprimtarinë e përditshme apo ta transferonin në vende të largëta. Ta nxisnin atë të vinte në dyshim realitetin që e rrethonte, me shpresën se do ta çmendnin. Zersetzung ishte një metodë efikase, sepse ishte gati gjithmonë e personalizuar. Ata që ishin përgjegjës për "zbërthimin mendor" të viktimës studionin tiparet e karakterit, vlerat dhe zakonet e tij, duke përpunuar sociograma dhe psikograma nga të cilat mund të zhvillohej strategjia e marginalizimit të tij. Jurgen Fuks, një intelektual rebel që ra viktimë e Zersetzung në vitet 1970, e përshkroi atë periudhë të pazakontë të izolimit të vazhdueshëm që zgjati me vite si një "krim psikosocial", dhe si "një sulm ndaj shpirtit njerëzor". Ashtu si ai, sipas disa vlerësimeve, të paktën 5-10 mijë njerëz ranë viktimë të Zersetzung gjatë epokës së Honeker. Ishte pikërisht Fuks, i dëbuar në Gjermaninë Perëndimore

në vitin 1977, ai që e ndërgjegjësoi publikun gjerman për Zersetzung. Ai nisi të publikonte në revistën "Der Spiegel" dëshmitë e tij së bashku me një sërë dokumentesh në lidhje me përdorimin e luftës psikologjike nga STASI. Ato do të pasoheshin nga një mori librash, dokumentarësh dhe investigimesh gazetareske. Edhe pse drejtësia ka mbajtur çuditërisht një qëndrim të paqartë ndaj kësaj çështjeje. Në të njëjtën kohë që STASI zbatoi me sukses Zersetzung, regjimi më i madh i mbikëqyrjes masive në planet – sipas numrit të spiunëve për frymë – u ngrit në Rumaninë e Nikolae Çausheikut. Por në atë kohë, kurset e riedukimit ishin në rritje dhe në Shtetet e Bashkuara. Edhe në vende demokratike, programet e manipulimit mendor u zbatuan me një intensitet të krahasueshëm me atë në vendet Perdes së Hekurt, nga programi "MKULTRA" tek "Mockingbird" dhe "COINTELPRO". Dhe sot si atëherë, asgjë nuk ka ndryshuar: qëllimi i njerëzve në krye të botës, mbetet të kontrollojnë mendjen e individëve. / Il Giornale – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Fillon shitja e biletave për ndeshjen Ballkani - Shkupi, çmimet përtokë

Ballkani e ka shkruar historinë si në futbollin vendor ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Pas titullit kampion në Kosovë, skuadra e drejtuar nga Ilir Daja është afër kualifikimit në fazën e grupeve në Ligën e Konferencës. Të enjten e zhvillon ndeshjen kthyesë ndaj Shkupit, të cilën skuadër e mposhti një javë më herët me rezultat 1-2. Klubi kampion ka menduar edhe për tifozët duke i vendosur çmimet përtokë të biletave

EPOKA ERE Veton ZYMBERI

SUHAREKË, 22 GUSHT - Skuadra e Ballkanit e zhvillon ndeshjen kthyesë të enjten ndaj Shkupit në stadiumin "Fadil Vokrri". Kampionët e Kosovës në futboll e fituan ndeshjen e parë dhe janë afër sigurimit të grupeve në Ligën e Konferencës. Biletat për këtë ndeshje kanë filluar të shiten, ndërsa çmimi i tyre është nga 1 euro deri në 10 euro. "Të dashur tifozë, ka filluar shitja e biletave për ndeshjen e radhës kundër FC Shkupi e cila do të zhvillohet të enjten në stadiumin 'Fadil Vokrri'. Biletat janë duke u

shitur fizikisht, te sheshi i qytetit në Suharekë dhe tek 'fan-shopi' i klubit i cili gjendet te stadiumi i qytetit - Suharekë. Të mërkurën dhe të enjten biletat do të dalin në shitje edhe në Prishtinë te New Borni. Biletat do të jenë në shitje nga ora 10:00 deri në orë 21:00", thuhet në njoftimin e skuadrës kampione.

Ballkani ka njoftuar se biletat për tribunat në lindje, veri, jug janë nga 1 euro, kurse në perëndim 3 euro. Biletat më të shtrenjta janë ato VIP që kushtojnë 10 euro. "Për këtë ndeshje klubi është kujdesur për të gjithë ju që çmimi i biletave të jetë i arsyeshëm. Jemi vetëm një hap



larg historisë. Nuk keni arsye për të munguar, pajisuni me biletë e shihemi në stadium! Ballkani ka nevojë për përkrahje", thuhet në njoftimin e skuadrës

suharekase. Skuadra e Ballkanit ka shkruar historinë pasi, përveç titullit kampion në Kosovë dhe pjesëmarrjes në parakualifikimet

në Ligën e Kampionëve, ka mundësi të kualifikohet në fazën e grupeve nëse e ruan rezultatin e ndeshjes së parë (1-2). Skuadra që drejtohet nga Ilir Daja gjithashtu e ka nisur me fitore sezonin e ri në elitën kosovare të futbollit, duke e mundur të dielën skuadrën e Drenicës me rezultat 1-0.

'Shvercerat' paralajmërojnë ardhjen në Prishtinë

Ndeshja kthyesë e Ligës së Konferencës pritet të jetë madhështore për faktin se drejt Prishtinës kanë paralajmëruar se do të vijnë edhe shumë tifozë nga Shkupi. Drejtori sportiv i Shkupit, Omer Bunjaku, në emisionin "Kampionët" ka njoftuar se 600 tifozë "Shvercerat" kanë kërkuar bileta për ndeshjen e mesjavës, e vlefshme për fazën e "play-off"-it, e cila është jetike për të dyja ekipet.

Kampionia Luiza Gega kthehet në Shqipëri: Kam vite që sakrifikoj

TIANË, 22 GUSHT - Kampionia e Evropës, Luiza Gega, e cila në bëri krenarë, duke fituar Medaljen e Artë në garën 3000 me pengesa në Kampionatin Evropian në Muni, është kthyer sot në Shqipëri. Ajo u prit në aeroportin e Rinasit nga Ministrija e Arsimit dhe Sportit, Evis Kushi dhe nga presidenti i KOKSh-it, Fidel Ylli. "Jam lodhur shumë për të qenë këtu ku jam sot. Kam shumë vite që sakrifikoj. Sot jam më krenare se kurrë për ato ngjyra. Kjo ishte dhe arsyeja pse unë derdha lot në vijën e finishit sepse m'u kthye koha mbrapsht sa me mund dhe sakrificë", është shprehur Luiza Gega e cila ka falënderuar



trajnerin e saj. "Jam shumë e lumtur që ia dola. E vetme nuk do t'ia kisha dalë kurrë pa mbështetjen e trajnerit. Ka pasur

më shumë besim tek unë seç kam pasur unë te vetja", ka shtuar Gega, e cila ka dominuar në një garë nga fillimi e deri në fund.

Superliga e basketbollit me emër të ri

Prishtinë, 22 gusht - Prince Caffè Superliga do të quhet elita e basketbollit të Kosovës në dy vitet e ardhshme. Bordi i FBK-së në mbledhjen e saj të rregullt ka vendosur disa ndryshime të reja. Edicioni i ri në Prince Caffè Superligën do të fillojë nga data 10 dhe 11 shtator. "Superliga e meshkujve në dy vitet e ardhshme do të marrë emrin Prince Caffè Superliga", thuhet në njoftimin e FBK-së. Bordi i FBK-së e ka miratuar në parim kërkesën e KB Bora Basket për t'u inkuadruar në



Ligën e Parë të meshkujve nga edicioni 2022/23 pas paraqitjes së projektit serioz dhe afatgjatë, me theks të veçantë zhvillimin e basketbollit ndër gjenerata të reja.

Asllani: Jam krenar që kam veshur fanellën kuqezi

MILANO, 22 GUSHT - Futbollisti shqiptar i Interit, Kristjan Asllani, ka rrëfyer tregime për jetën e tij në kanalin zyrtar të Serisë A. "Kam lindur në Elbasan në Shqipëri dhe kam një lidhje të fortë me tokën time. Jam shumë krenar për origjinën dhe po ashtu që kam veshur fanellën e kombëtares shqiptare", shprehet mesfushori i Interit. "Pastaj jam transferuar me familjen në Itali. Empoli është një qytet shumë i rëndësishëm, kam kaluar 13 vjet të jetës sime aty ku jam rritur si njeri dhe si

lojtar. Qyteti tjetër që më ka shënjuar është ky ku jam tani, Milano, është e tashmja dhe e ardhmja ime. Unë kurrë nuk kam pasur një idhull, por kam admiruar disa lojtarë për karakterin dhe teknikën e tyre, si Schnajderin e Pirlon. Mësimi më i rëndësishëm që mbaj gjithmonë me vete është të qëndroj i përlulur dhe t'i mbaj këmbët fort në tokë", ka deklaruar Asllani. "Goli më i rëndësishëm për mua ishte ai që shënova në 'San Siro' kundër Interit sezonin e kaluar. Ishte goli

im i parë dhe i vetëm në Serinë A dhe nuk harrohet kurrë. Tani unë jam pjesë e kësaj skuadre dhe është disi e çuditshme, por ai gol, goditja me të djathtën pas kontrollit të topit të gjatë të Fiamocit, është pjesë e rrugës që më solli deri këtu. Ndërkohë, me Interin nuk kam gjetur ende golin e parë zyrtar, por ndaj Monakos shënova me të majtën dhe mbi të gjitha mbaj mend reagimin e publikut zikaltër. Si tifoz interist, t'i dëgjoja emrin tim të brohoritur prej tyre, ishte një emocion i madh", ka shtuar Asllani.



Casemiro i thotë lamtumirë Realit: Do të rikthehem sërish, ky klub më dha shumë

MADRID, 22 GUSHT - Casemiro është përshëndetur me Real Madridin për t'u transferuar te Manchester Unitedi. Pas nëntë vjetësh në fanellën merengues, mesfushori brazilian foli nga "Bernabeu" për t'i thënë

zyrtarisht lamtumirë klubit me të cilin bëri historinë. Ai u shfaq shumë i emocionuar, ku nuk munguan as lotët. "Kur u largova nga Sao Paulo e kisha shumë të qartë se do të luaja në ekipin e parë të Real

Madridit. Në Madrid kam ndërtuar jetën time, familjen time. Kam fituar shumë tituj, por më e rëndësishmja ishte se stërvitesha çdo ditë te Reali. Me Modriqin dhe Kroosin kemi arritur rezultate të

shkëlqyera, kam shijuar futbollin dhe një ditë do të kthehem patjetër në këtë klub për ta kthyer gjithë dashurinë që kam marrë dhe të vazhdoj ta jap ndihmën time", ka thënë Casemiro.



Albion Pllana, 'ylli i javës' në Superligë

PRISHTINË, 22 GUSHT - Federata e Futbollit e Kosovës, së bashku me sponsorin e Superligës, Albi Mall, pas çdo xhiroje, do ta shpallin "yllin e javës". Vlerësimi do të bëhet nga komisioni prej tre anëtarësh nga Liga e Veteranëve të Futbollit të Kosovës. Këtë javë komisioni në përbërje: Shyqeri Salihu nga KFV Lipjani, Bujar Asllani nga KFV Ferizaj dhe Zenel Shabani nga KFV Vjosa vendosën unanimitisht që ky çmim t'i takojë futbollistit të KF Trepça '89 FC, Albion Pllana. Kështu, për herë të dytë radhazi çmimi "ylli i javës" shkon te skuadra mitrovicase, pasi në javën e parë epitetin e më të mirit e fitoi sulmuesi nigerian Christian Mba.

Albion Pllana hyri në lojë si zëvendësues në ndeshjen kundër Llapit në "Zahir Pajaziti" dhe arriti të shënojë dy gola, duke qenë më i merituari që Trepça '89 arkëtoi pikën e dytë në këtë edicion, një vit pas rikthimit në elitë. Ai shënoi golin e parë në minutën e 74-t me gjuajtje me kokë dhe të dytin në



minutën e 80 nga afërsia pas asistimit nga Mba. Përveç golave të shënuara, komisioni vlerësoi se Pllana pati paraqitje të mirë gjatë tërë minutave që kishte në dispozicion.

Çmimin "ylli i javës" futbollistit të Trepçës '89 ia dorëzoi menaxherja e marketingut në Albi Mall, Fitore Osmani-Muhaxhiri. Pas marrjes së këtij çmimi, Pllana u shpreh i lumtur për vlerësimin si dhe për

faktin që golat e tij i dhanë skuadrës së tij një pikë. "Ky shpërblim për mua është shumë domethënës. I falënderoj ata që e vlerësuan paraqitjen time, si dhe shokët e ekipit dhe trajnerët për angazhimin dhe punën që po e bëjmë në çdo ndeshje. Trepçën '89 e shoh sa më lart këtë vit, pasi kemi ekip shumë të mirë dhe të gjithë djemtë luajnë me përkushtim të madh", ka theksuar Pllana.

Ikona e NBA-s: Putinin e njoh mirë, do të shkoj në Rusi për të negociuar për lirimin e Griner

CHICAGO, 22 GUSHT - Ish-basketbollisti Dennis Rodman, tashmë 61 vjeç, një nga ikonat e NBA-s (pesë tituj kampionë me Detroit dhe Chicago), ka befasuar me deklaratën dhënë për mediet amerikane. Ai ka thënë se do të shkojë në Rusi për të negociuar për lirimin e basketbollistes Britney Griner, e dënuar me nëntë vjet burg për trafikim të lëndëve narkotike. "Krimbi", siç njihet ndryshe Rodman, njihet për miqësinë që ka me kreun e Koresë së Veriut, Kim Jong Un. Në të shkuarën ai ka negociuar dhe kontribuar për lirimin e amerikanit Kenneth Bae, i burgosur në Korenë e Veriut. "Kam lejen për të shkuar në Rusi dhe ta ndihmoj atë vajza për ta mundësuar lirimin e saj. Po përpiqem të shkoj në Rusi që këtë javë. E njoh mjaft mirë



Vladimir Putinin", u shpreh Dennis Rodman për "NBC News". Griner është arrestuar që në shkurt të këtij viti, kur në aeroport iu gjet vaj kanabisi, të cilën ajo e përdorte si

trajtim mjekësor. Ky justifikim nuk u mor parasysh dhe basketbollistja që luan për Ekateringurg u arrestua dhe një muaj më parë u dënua me nëntë vjet burgim.

SHKURT

Spalletti: Rrahmani dhe Kim duhet të marrin më shumë pjesë në lojë

Luciano Spalletti është i kënaqur me fitoren e Napolit ndaj Monzas me rezultat 4-0 në fundjavë, mirëpo trajneri italian e ka zbuluar një kërkesë që ia ka bërë Amir Rrahmanit, por edhe përforcimit të napolitanëve, Kim Ming-Jae, i cili po luan përkrah qendërmbrojtësit nga Kosova. "Rrahmani bëri lojë të mirë, njëjtë si Kim. Por, ata duhet të marrin më shumë pjesë në ndërtimin e lojës. Është e nevojshme të futen më shumë në manovra. Mund të bëjnë më shumë dhe më mirë. Prej tyre nis gjithçka, aty nis presioni i kundërshtarit", ka deklaruar Spalletti.

Partizani synon transferimin e Mavrajt

Ish-kapiteni i Kombëtares së Shqipërisë, Mërgim Mavraj, aktualisht është pa ekip, pas përfundimit të aventurës me klubin e Kategorisë së katërt gjermane Turkuçu Mynih. Burime pranë klubit të Partizanit bëjnë me dije për "Panorama Sport" se Partizani i ka bërë një propozim paraprak 36-vjeçarit, por për momentin nuk ka asnjë hap para. Mavraj e ka me dyshim të madh të lërë jetën e krijuar prej vitesh në Gjermani, ku ka edhe aktivitete të tjera përveç futbollit dhe të jetojë në Shqipëri. Gjithsesi, kontaktet ekzistojnë dhe deri në mbyllje të merkatos gjithçka është e hapur, sepse e shkuara ka treguar se asgjë "nuk pritet me thikë".

Silva: Jam i lumtur në City

Bernardo Silva ka folur në lidhje me të ardhmen e tij. E ardhmja e Bernardo Silvas është ende në ajër, por portugezi donte ta bënte të qartë pas ndeshjes ndaj Newcastle Unitedit se ai është i lumtur te Manchester City mes thashethemeve dhe informacioneve për nënshkrimin e tij të mundshëm me Barçën. "Jam i lumtur këtu. Po bëj gjithçka që është e mundur për ta ndihmuar klubin. Jam shumë i fokusuar", ka thënë Silva për faqen e klubit anglez. Përveç Barcelonës, edhe Paris Saint Germaini ka shfaqur interesim për mesfushorin portugez.

Wijnaldumi mungon tre muaj

Georginio Wijnaldum ka pësuar një lëndim. AS Roma mund të rikthehet në tregun e transferimeve, pasi Georginio Wijnaldum pritet të jetë jashtë për të paktën tre muaj pas një lëndimi të pësuar në stërvitje. "Pas një lëndimi të pësuar gjatë stërvitjes të dielën pasdite, Georginio Wijnaldum më pas iu nënshtrua testeve mjekësore që konfirmuan praninë e një frakture në tibia në këmbën e djathtë", thuhet në një deklaratë. Lojtari do t'u nënshtrohet vlerësimeve të mëtejshme në ditët në vijim. FORZA GINI!". Sugjerimet fillestare që dolën nga Roma janë se nëse holandezi operohet, ai mund të kthehet brenda tre muajve, duke i dhënë atij një shans të vogël për t'u rikuperuar në kohë për Kupën e Botës 2022 në nëntor.

Verstappen: Këtë vit kam pasur fat, por kam makinën e duhur

Në prag të rikthimit të garave të Formulës 1, që këtë fundjavë spostohen në pistën belge të SPA-s, ka folur për mediet piloti holandez Max Verstappen. Ai nuk shqetësohet nga

pakënaqësitë që kanë fansat e ndryshëm në lidhje me betejën që ai ka pasur me Lewis Hamiltonin apo me duelin aktual ndaj Charles Leclerc. "Secili ka personalitetin e tij dhe kjo vlen si

për mua ashtu dhe për pilotët e tjerë. Unë shqetësohem për gjërat përreth meje, përqendrohem te puna ime, për të fituar çdo garë. Mua më pëlqen të garoj, të fitoj edhe pse në sportin tonë shpesh

duhet edhe fati për t'ia dalë mbanë", ka thënë holandezi i Red Bull. "Këtë vit kam pasur fat, por kam makinën e duhur dhe njerëzit e duhur përreth meje, që bëjnë të mundur që gjithçka të

funksionojë ashtu si duhet. Ky është një sport mjaft i vështirë, kërkon shumë përqendrim dhe gjithnjë shpreson që gjërat të shkojnë ashtu si duhet", ka shtuar Max Verstappen.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Spitali special për terapi me rehabilitim Onix SPA" L.L.C. Banjë, Istog, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për centralin solar fotovoltaik, 500kW në Carrallukë, Baicë, Orroberdë komuna e Istogut.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 20.09.2022 në ora 13:30 në hapësirat e restorant "ONIX SPA" Rr. "Onix" Nr. 66, 31010 Banjë, Istogdo të organizohet debat publik nga Kompania "Spitali special për terapi me rehabilitim Onix SPA" L.L.C. Banjë, Istog, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për centralin solar fotovoltaik, 500kW në Carrallukë, Baicë, Orroberdë komuna e Istogut.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=NjkeHFBUzjGZEc4dXUzeGx2NXVtZz09>
Meeting ID: 454

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "Spitali special për terapi me rehabilitim Onix SPA" L.L.C. Banjë, Istog për centralin solar fotovoltaik, 500kW në Carrallukë, Baicë, Orroberdë komuna e Istogut.

https://mmpi.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "ACHRO" Sh.p.k Bregu i Diellit, Prishtinë, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për minierën e kromit të varfëruar dhe deponin e shkëmbit ultra bazik (qe do te gjenerohet nga kjo miniere) në Gorancë, Hani i Elezit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 20.09.2022 në ora 09:00 në hapësirat e restorant "AlbaOil" rruga "Adem Jashari", pn Hani Elezitdo të organizohet debat publik nga Kompania "ACHRO" Sh.p.k Bregu i Diellit, Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për minierën e kromit të varfëruar dhe deponin e shkëmbit ultra bazik (qe do te gjenerohet nga kjo miniere) në Gorancë, Hani i Elezit.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=NjkeHFBUzjGZEc4dXUzeGx2NXVtZz09>
Meeting ID: 454

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "ACHRO" Sh.p.k Bregu i Diellit, Prishtinë për minierën e kromit të varfëruar dhe deponin e shkëmbit ultra bazik (qe do te gjenerohet nga kjo miniere) në Gorancë, Hani i Elezit.

https://mmpi.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



Bazuar në dispozitat 38.3 dhe 38.4 të Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) shpall:

KONKURS për Zëvendësguvernator

BQK është institucion i pavarur i themeluar me ligj të veçantë, ndërsa funksionet e saja kryesore janë: të sigurojë sistem financiar të qëndrueshëm; të rregullojë, licencojë dhe mbikëqyrë institucionet financiare; të mirëmbajë sistem të pagesave të sigurt dhe efikas; të kontribuojë në stabilitetin e çmimeve; të menaxhojë rezervat ndërkombëtare të vendit; të veprojë si bankier, agjent fiskal dhe këshilltar financiar për Qeverinë dhe entitetet e tjera publike; të kryejë analiza ekonomike dhe prodhojë statistika monetare-financiare dhe të bilancit të pagesave.

Krahas plotësimit të kriterëve të përcaktuara me nenet 40 dhe 41 të Ligjit për BQK-në, të gjithë kandidatët duhet t'i njohin politikat dhe aktivitetet me rëndësi ndërlidhur me misionin, objektivat dhe kompetencat e BQK-së, të kenë përvojë të theksuar në vendimmarrje dhe në menaxhimin e burimeve njerëzore dhe të proceseve, të posedojnë veçori personale që reflektojnë integritet dhe reputacion të lartë, si dhe të demonstrojnë aftësi të shkëlqyeshme ndërpersonale dhe komunikuese.

Zëvendësguvernatori ndihmon Guvernatorin në realizimin e detyrave të tij dhe të njëjtit i delegohen detyra specifike nga ana e Guvernatorit.

Të gjithë kandidatët duhet t'i parashtrojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë;

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është 5 shtator 2022.
- Aplikimi mund të bëhet përmes postës elektronike paneli@bqk-kos.org ose përmes Arkivit të BQK-së, rr. Garibaldi nr. 33.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes ueb-faqes: www.bqk-kos.org
- Vetëm kandidatët e përzgjedhur nga ana e panelit do të thirren në intervistë.



Na osnovu člana 38.3 i 38.4 Zakona o Centralnoj banci Republike Kosova, Centralna banka Republike Kosovo (CBK) raspisuje:

KONKURS za Zamenika guvernera

CBK je nezavisna institucija osnovana posebnim zakonom, dok njene glavne funkcije su: obezbeđivanje stabilnog finansijskog sistema; reguliše, licencira i nadzire finansijske institucije; održava siguran i efikasan platni sistem; doprinosi stabilnosti cena; upravlja međunarodnim rezervama zemlje; deluje kao bankar, fiskalni agent i finansijski savetnik za Vladu i druge javne entitete; sprovodi ekonomsku analizu i izrađuje monetarnu-finansijsku statistiku i platni bilans.

Pored ispunjavanja kriterijuma utvrđenih članovima 40. i 41. Zakona o Centralnoj banci Republike Kosova, svi kandidati moraju ispuniti i druge dodatne kriterijume vezane za poznavanje politika i aktivnosti od značaja u vezi sa misijom, ciljevima i nadležnostima CBK-a, imaju značajno iskustvo u donošenju odluka, upravljanje ljudskim resursima i procesima, poseduju lične osobine koje odražavaju integritet i visoku reputaciju, kao i da demonstriraju odlične međuljudske i komunikativne sposobnosti.

Zamenik guvernera pomaže guverneru u obavljanju svojih dužnosti i istom se delegiraju specifični zadaci od strane guvernera.

Svi kandidati treba da dostave sledeće dokumente:

- Zvanični obrazac CBK –a za apliciranje;
- Prateće (motivaciono) pismo gde se naglašava interesovanje za ovu poziciju;
- Dokaz o identitetu i stalnom boravku na Kosovu;

Procedura apliciranja:

- Krajnji rok za apliciranje je 5 septembar 2022.
- Aplikacija može biti poslata elektronskom poštom paneli@bqk-kos.org ili putem arhive CBK-a, ul. Garibaldi br. 33.
- Obrazac za apliciranje možete preuzeti putem veb stranice: www.bqk-kos.org
- Samo kandidati odabrani od strane panela biće pozvani na intervju.



Në bazë të Nenit 8 të Ligjit të Punës (Ligji nr. 03/L-212), UA MPMS nr. 07/2017 dhe Rregullores për Rregullimin e Marrëdhënies së punës 01/2710/2021, datë 09.11.2021 dhe Vendimin e Bordit të Drejtorëve me nr. 01-1822/2022, datë 19.08.2022 PK Sh.A. shpall:

KONKURS PUBLIK PËR VENDE PUNE

Titulli i pozitës:

1. Postier/e, (grada 3) 18 Ekzekutues
2. Punëtor/e Sporteli, (grada 5) 12 Ekzekutues

Nr. Referencës: 05-1819/2022 datë 19.08.2022 dhe Nr. 01-1822/2022 datë 19.08.2022

Përshkrimi: PK Sh.A., është duke bërë përpjekje për të zhvilluar biznesin sipas përvajave më moderne të shërbimeve postare dhe komerciale, për t'i arritur standardet ndërkombëtare në ofrimin e shërbimeve postare dhe komerciale. Në këtë aspekt, PK Sh.A., ofron mundësi të barabartë punësimi të profesionistëve që synojnë të jenë pjesë e zhvillimit të biznesit dhe kompetencave të Ndërmarrjes në përputhje me metodat dhe praktikat moderne.

Kohëzgjatja e kontratës: Konform nenit 4 dhe 15 të Rregullores për Rregullimin e Marrëdhënies së Punës për Punonjësit e Postës së Kosovës Nr. 01/2710/2021 datë 09.11.2021, kontrata e punës është për kohë të pacaktuar, në të cilën periudhë përfshihet edhe periudha provuese 6 muaj.

Aplikimi: Aplikacionet mund të merren online www.postakosoves.com dhe së bashku me dëshmitë përkatëse të dërgohen nëpërmjet postës në adresën: **Arkiva e PK Sh.A., Ndërtesa Kryesore e PK-së, Rr. "28 Nëntori" nr. 4, 10000 - Prishtinë**, deri në afatin e paraparë për aplikim me shenjë "PËR KONKURS", duke e cetur titullin e vendit të punës dhe Regjionin për të cilin aplikoni.

Aplikacioni dhe të gjitha dëshmitë bashkëngjiten të fotokopjuara, sepse të njëjtat nuk iu kthehen aplikantëve.

Aplikacionit patjetër duhet t'i bashkëngjitet dëshmia (vërtetimi) se aplikanti/ja nuk është nën hetime dhe i/e dënuar.

Aplikacionet e pakompletuara plotësisht nuk do të merren parasys.

Aplikacionet të cilat dorëzohen pas afatit nuk do shqyrtohen.

Afati i fundit për aplikim: 05.09.2022, ora 16:00.

Pozita e punës: Postier

Vendi i punës: Regjioni Prishtinë (Kastriot: 1 Ekzekutues, Besianë: 1 Ekzekutues , Prishtinë: 5 Ekzekutues)

Vendi i punës: Regjioni Prizren (Prizren: 3 Ekzekutues, Ratkoc:1 Ekzekutues, Krushë e Madhe: 1 Ekzekutues)

Vendi i punës: Regjioni Gjilan (Viti: 1 Ekzekutues, Gjilan: 1 Ekzekutues, Kamenicë: 1 Ekzekutues)

Vendi i punës: Ferizaj (Kaçanik: 2 Ekzekutues, Ferizaj: 1 Ekzekutues)

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Pranon dhe shpërndan letër-dërgesat, kolipostat, apo produktet tjera që ofron PK Sh.A., të ndara/ngarkuara nga kartuesi/ja; Është përgjegjës/e për pranimin, dorëzimin e letër-dërgesave, kolipostave në rajonin përkatës; Bën shitjen e produkteve sipas shërbimeve që ofrohen nga PK Sh.A. dhe është përgjegjës/e për arritjen e targeteve të caktuara nga qendra për shitjen e produkteve; Mbanë përgjegjësi për produktet e pranuar për shitje, tel. USSD, evidencë, klasifikim dhe ruajtje të dokumentacionit manipulativ në baza ditore, dekadore dhe mujore; Zbaton ndryshimet e paraqitura në lidhje me shpërndarjen dhe dorëzimin; Është përgjegjës/e për mirësjellje, zbatimin e Kodit të Mirësjelljes dhe Kodit mbi Trajtimin e Dërgesave Postare; Kryen edhe punë tjera të nevojshme të parashtruara nga Kontrollori i Shpërndarjes/Kartuesi apo Përgjegjësi i Zyrës Postare; Për punën e vet i përgjigjet Kontrollorit të Shpërndarjes/Përgjegjësit të Zyrës Postare.

Kualifikimi dhe përvoja e nevojshme:

Punonjësi/punonjësja, për ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi të Postierit/es duhet të ketë kualifikim të mesëm, preferohet në drejtimin e shërbimit postar.

Pozita e punës: Punëtor/e Sporteli

Vendi i punës : Prishtinë, (Magurë: 1 Ekzekutues)

Vendi i punës: Prizren, 6 Ekzekutues (Prizren: 3 Ekzekutues, Suhareke: 1 ekzekutues, Dragash: 1 ekzekutues dhe Korishë: 1 Ekzekutues)

Vendi i punës: Gjakovë, 1 Ekzekutues (Rogovë: 1 Ekzekutues)

Vendi i punës : Gjilan, 2 Ekzekutues (Kamenicë: 1 Ekzekutues, Gjilan: 1 Ekzekutues)

Vendi i punës : Ferizaj, 2 Ekzekutues (Kaçanik: 1 Ekzekutues, Ferizaj: 1 Ekzekutues)

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Ofron shërbime dhe shet të gjitha produktet në sportel, përfshirë edhe implementimin e dimensioneve të parapara dhe raportimin. Është përgjegjës/e për ofrimin dhe shitjen e të gjitha produkteve dhe shërbimeve; Mban përgjegjësi për furnizim të rregullt, ngarkesë me pulla, vlera postare dhe produkte për shitje; Është përgjegjës/e për klasifikimin dhe ruajtjen e dokumentacionit manipulativ financiar në baza ditore, dekadore dhe mujore; Është përgjegjës/e për mirësjellje dhe zbatimin e Kodit të Mirësjelljes; Raporton të Kontrollori/ja i/e Ndërrimit ose Përgjegjësi/ja i/e Postës në baza ditore, dekadore dhe mujore; Kryen edhe punë tjera të nevojshme, të parashtruara nga Kontrollori/ja ose Përgjegjësi/ja i/e Postës; Për punën e vet i raporton Kontrollorit të ZP/Përgjegjësit të Zyrës Postare.

Kualifikimi dhe përvoja e nevojshme:

Punonjësi/punonjësja, për ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi të Punëtorit/es së Sportelit duhet të ketë kualifikim universitar ose kualifikim të mesëm dhe së paku 1 vit përvojë pune në ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi të ngjashme si në përshkrimin e vendit të punës.

Kandidatët që i plotësojnë kushtet fillimisht do t'i nënshtrohen testit me shkrim dhe vetëm ata kandidatë, të cilët do të kalojnë testin, do të hyjnë në rrethin e ngushtë dhe do t'i nënshtrohen intervistës.



U sklado sa članom 8. Zakona o radu (Zakon br. 03 / L-212), Administrativno Uputstvo Ministarstva Rada i Socijalne Zaštite br. 07/2017 i Pravilnik o regulisanju radnih odnosa 01/2710/2021 datum 09.11.2021 PK A.D.i odluka upravnog odbora Br 01-1822/2022, datum 22.08.2022 objavljuje:

JAVNI KONKURS ZA RADNO MESTO

Naziv radnog mesta: 1. Poštar/ka (rang 3) 18 Izvršni

2. Šalterski Radnik,(rang 5) 12 Izvršni

Referentni Br. 05-1819/2022 datum 19.08.2022 dhe Br 01-1822/2022 datum 19.08.2022

Opis:

PK A.D. nastoji da razvije poslovanje u skladu sa najsavremenijim iskustvima poštanskih i komercijalnih usluga, kako bi zadovoljio međunarodne standarde u pružanju poštanskih i komercijalnih usluga. U tom smislu, PK A.D. pruža mogućnosti zapošljavanja za profesionalce koji imaju za cilj da budu deo razvoja poslovanja i nadležnosti Proizveća skladu sa savremenim metodama i praksama.

Trajanje Ugovora: U skladu sa članovima 4 i 15 Pravilnika o regulisanju radnih odnosa za zaposlene u Pošti Kosova Br 01-2710/2021 datum 09.11.2021. ugovor o radu je na neodređeno vreme, koji uključuje probni period od 6 meseci.

Aplikacija: Aplikacije možete preuzeti na internetu www.postakosoves.com i zajedno sa relevantnim dokazima poslatim poštom na adresu: **Arhiva PK A.D. "Glavna zgrada PK, Ul. 28. Novembar Br. 4, 10000 – Priština"**, do roka za prijavu obeležen naznakom "ZA KONKURENCIJU", navodeći naziv radnog mesta za koji se prijavljujete i region za koji prijavljujete .

Aplikacije i svi dokazi priložiti fotokopirane, jer se isti ne vraćaju podnosiocima prijave.

Aplikacije se moraju priložiti dokaz (potvrda) da podnosilac prijave nije pod istragom ili osuđen.

Zahtevi koji su poslani nakon poslednjeg datuma neće biti prihvaćeni. Nepotpuni zahtevi će biti odbijeni

Zadnji rok za prijavu: 05.09.2022, vreme 16:00 časova.

1. Poštara/ke 18 izvršioaca

Radno Mesto : Region Pristina (Obilic 1 izvršilac, Podujevo 1 izvršilac, Pristina 5 izvršilac)

Radno Mesto : Region Prizren (Prizren 3 izvršilac , Ratkoc 1 izvršilac, Velika Krusa 1 izvršilac)

Radno Mesto : Region Gnjilan (Viti 1 izvršilac, Gnjilan 1 izvršilac, Kamenica 1 izvršilac)

Radno Mesto: Region Urosevac (Kacanik 2 izvršilac, Ferizaj 1 izvršilac)

Glavne dužnosti i odgovornosti:

Primi i isporučuje pismonosne pošiljke, paket ili druge proizvode koje pruža PK A.D. odvojene/zadužene od Kartista; Odgovoran je za prijem, predaju pismonosnih pošiljka, paketa u odgovarajućoj regiji; Prodaje proizvode prema uslugama koje pruža PK A.D. i odgovoran je za postizanje određenih ciljeva iz centra za prodaju proizvoda; Odgovoran za proizvode primljene za prodaju, tel., USSD, evidenciju, klasifikaciju i očuvanje manipulativne dokumentacije svakodnevno, dekadentno i mesečno; Primenjuje promene predstavljene u pogledu dostave i uručjenja; Odgovoran za učtivost, sprovođenje Kodeksa ponašanja i Kodeksa za rukovanje poštanskim pošiljkama; Obavlja i druge neophodne poslove postavljene od Kontrolora Distribucije/Kartista ili Odgovornog lica pošte; Za svoj rad, izveštava Kontroloru Distribucije/Odgovornog lica pošte.

Radno mesto

2.Radnik/ca Šaltera,

Radno Mesto : Region Pristina (1izvršioc-Magura)

Radno Mesto : Region Prizrenu (Prizren 3 izvršilac, Suvareka 1 izvršilac, Dragash 1 izvršilac,

Korisa 1 izvršilac)

Radno Mesto : Region Dakovo (Rogovo 1 izvršilac)

Radno Mesto: Region Gnjilan (Kamenica 1 izvršilac, Gnjilan 1 izvršilac)

Radno Mesto : Region Urosevac (Kacanike, 1 izvršilac, Urosevac 1 izvršilac)

Glavne dužnosti i odgovornosti:

Pružna prodajne usluge svih proizvoda na šalteru, uključujući i realizaciju predviđenih dimenzija i izveštavanja; Odgovoran je za pružanje i prodaju svih proizvoda i usluga; Odgovoran je za redovno snabdevanje poštanskih marka, poštanskih vrednosti i proizvode za prodaju; Odgovoran je za klasifikaciju i održavanje finansijskih manipulativnih dokumenata svakodnevno, dekadentno i mesečno; Odgovoran je za učtivost i primenu Kodeksa ponašanja; Izveštava svakodnevno, dekadentno i mesečno Kontroloru smene ili Odgovornog lica pošte. Obavlja i druge neophodne poslove postavljene od Kontrolora, ili Odgovornog lica pošte; Za svoj rad, izveštava Kontroloru / Odgovornom licu pošte.

Obrazovanje, veštine i ostalo:

Zaposlenik/zaposlenica za obavljanje dužnosti i odgovornosti Radnik Šaltera treba imati univerzitetsku kvalifikaciju ili kvalifikaciju srednje škole i radno iskustvo najmanje 1 godinu u vršenju sličnih dužnosti i odgovornosti kao u opisu radnog mesta.

Kandidati koji ispunjavaju uslove prvo će polagati pismeni test, a samo kandidati koji polože test će ući u užu krug i obaviti intervju



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejite

RESTAURANT

SWISS
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Albert Lekaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M.T. "Nexhmedin Nixha" Gjakovë drejtimi kamerier.

▶ Fatmir Gubetini shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme "7 Shtatori" drejtimi Hoteleri Prishtinë.

▶ Diamant Hoxha B.I. emri tregtar "Hox Media" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 810063165.

▶ Freskim Radoniqi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit " Hajdar Dsuih" Gjakovë.

▶ Shemsedin Haradinja nga Gllgjani KK Deqan shpall të pavlefshme dëftesën e kl. IV të SH.M.T. QAMO "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

▶ Urgjentisht kërkohet një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

